

VENDIM
Nr.566, datë 5.9.2007

**PËR MIRATIMIN E PROCEDURAVE TË SHPËRNDARJES SË FONDIT TË
KOMPENSIMIT, NË TË HOLLA, PËR VITIN 2007**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 17 të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Subjektet e shpronësuara, prona e të cilave është njohur e gjitha për kompensim dhe që i përket atyre qarqeve, rretheve apo qyteteve, për të cilat është miratuar harta e vlerës së pronës, që nuk kanë përfituar nga kompensimet financiare të mëparshme, të kompensohen, sipas radhës kronologjike, të përcaktuar nga numri i vendimit, sipas viteve.

2. Vlera e kompensimit të jetë e njëjtë, deri në 200 m² të sipërfaqes së përcaktuar për kompensim.

3. Subjektet, që kanë depozituar kërkesat e tyre në vitet 2005 e 2006 dhe vërtetojnë kryerjen e pagesës, nuk paguajnë tarifën e aplikimit, për vitin 2007.

4. Subjekti duhet të plotësojë dhe të paraqesë, pranë zyrës së AKKP-së në qendër, dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) Formularin tip, që i bashkëlidhet këtij vendimi, të plotësuar;
- b) Kërkesën për kompensim financiar, për pronën e njohur dhe të përcaktuar për kompensim;
- c) Vendimin e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave/Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, për njohjen dhe kompensimin e pronës;
- ç) Dëshminë e trashëgimisë;
- d) Prokurën e posaçme, të nënshkruar nga të gjithë trashëgimtarët e ligjshëm;
- dh) Fotokopjen e noterizuar të dokumentit të identifikimit (pasaportë, certifikatë ose letërnjoftim) të personit, që ka prokurën e përfaqësimit;
- e) Mandatpagesën.

5. Zyra e AKKP-së në qendër, në bashkëpunim me zyrat rajonale, shqyrton dokumentacionin e subjekteve, që kërkojnë kompensim dhe kryen veprimet e mëposhtme:

- a) Verifikon dosjen dhe vendimin përkatës, të dhënë nga Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave/Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave;
- b) Verifikon në zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, të cilat, brenda 5 ditëve, konfirmojnë çdo të dhënë, vlefshmërinë dhe çdo të dhënë tjetër për vendimin përkatës;
- c) Verifikon çdo dokument, që vërteton se prona ka ndryshuar gjendjen juridike të pronësisë, nga çasti i daljes së vendimit, në favor të subjektit të shpronësuar;
- ç) Llogarit vlerën e kompensimit për secilin subjekt të shpronësuar;
- d) Përgatit planvendosjen e pjesës përfituese të pronës, që kompensohet;
- dh) Shpall listën e subjekteve përfituese në mjediset e zyrës qendrore dhe të zyrave rajonale të AKKP-së, si dhe në median e shkruar dhe atë elektronike;
- e) Miraton vendimin e kompensimit, për secilin subjekt të shpronësuar, të shoqëruar me planvendosjen e pjesës përfituese të pronës, që kompensohet, vlerësimin dhe relacionin përkatës.

6. Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, në mbështetje të fondeve të planifikuara në Buxhetin e Shtetit, bën kalimin e fondit të kompensimit financiar, në emër të subjektit të shpronësuar, përfitues të kompensimit, apo të përfaqësuesit të tij me prokurë, në përputhje me procedurat për zbatimin e Buxhetit të Shtetit.

7. Procesi i regjistrimit/pranimi të kërkesave për kompensim fillon 5 ditë pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi dhe vazhdon për 20 ditë.

8. Ngarkohet Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Formular Tip

K E R K E S E

PER FORMEN E KOMPENSIMIT TE PRONES

Drejtuar: Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave

Data e paraqitjes se kërkesës: ____/____/____

Emri / Atësia / Mbiemri i subjektit të shpronësuar që paraqet
kërkesën ____/____/____
Emri Atësia Mbiemri

Adresa: _____;
Tel. /Fax. _____

E-mail: _____

Kërkesë për formën e kompensimit të pronës (Shëno brenda kuadrateve një ose disa numra, nga 1 (një) deri në 6 (gjashtë) sipas preferencës. Numri 1 tregon preferencën parësore dhe në mënyrë zbritëse numri 6 atë që ju preferoni më pak).

-- Me pronë të paluajtshme publike që ndodhet në zona me përparësi zhvillimin e turizmit.....

-- Me pronë tjetër të paluajtshme të të njëjtit lloj, me vlerë të barabartë, në pronësi të shtetit

- Me pronë tjetër të paluajtshme të çdo lloji, me vlerë të barabartë, në pronësi të shtetit.....

-- Me aksione në shoqëri me kapital shtetëror, ose ku shteti është bashkëpronar, që kanë vlerë të barabartë me pronën e paluajtshme.....

-- Me vlerën e objekteve, të cilat janë objekt i privatizimit

-- Me të holla.....

Nënshkrimi i kërkuarit _____